REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosova
Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije
Ministry of Finance
Arkiva - Arhiva - Archive
Njësia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 06/400
Nr. Prot. / Br. Prot. / Prot. No.: 1336-1/2021
Nr. i faqeve / Broj stranica / No. pages: 7
Data / Datum / Date: 15.11.2021
Dorëse
PRISHTINË/A

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTRIA E MBROJTJES/MINISTARSTVO ODBRANE/MINISTRY OF DEFENCE
HYRESE
Nr.Prot: / Br.Prot: / No.Prot: 2526/1
Nr. i Faqeve / Br. Stranica / No. of pages: 8
Data / Datum / Date: 16/11/2021
Prishtinë / a

Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

Ministarstvo Finansija, Rada i Transfera – Ministry of Finance, Labour and Transfers

Departamenti i Buxhetit - Odeljenje Budžeta- *Budget Departament*

DATË	12.11.2021
REFERENCË	NIS – 310/-2021
PËR/ZA/TO:	Z. Avdylkadër Muçaj, Drejtor i Departamentit Ligjor, Ministria e Mbrojtjes
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Enis Spahiu, zv. Sekretar i Përgjithshëm, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
NGA/OD/FROM:	Salvador Elmazi, Drejtor i Departamentit të Buxhetit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinioni i Departamentit të Buxhetit për vlersimin e ndikimit buxhetor për Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në formë granti sipas aktit për ndihmë të jashtme të vitit 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armëve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës

I nderuar z. Muçaj,

Bazuar në kërkesën për Vlerësimin e Ndikimit Buxhetor për Projektligjin për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në formë granti sipas aktit për ndihme të jashtme të viti 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armëve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës (të përgatitur nga propozuesi - Ministria e Mbrojtjes), obligimin sipas nenit 9 të Ligjit Nr. 03/L-221 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe nenit 19 të Ligjit Nr. 07/L-041 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin me Nr.08/L-016.

Departamenti i Buxhetit të Kosovës, paraqet me sa vijon:

I. ASPEKTE TË PËRGJITHSHME TË PROJEKTLIGJIT

Ky projektligj ka për qellim ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në formë granti sipas aktit për ndihmë të jashtme të vitit 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armeve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ky projekt ligj ndërlidhet drejtpërsëdrejti me objektivat dhe prioritet e Qeverise me programin Qeverise së Republikës së Kosovës për vitet 2021-2025, konkretisht ndërlidhet me zgjerimin e hartës së bashkëpunimit dy palësh me shtete partnere siç janë Shtetet e Bashkuara te Amerikës per arritjen e qasjes ndërshtetërore dhe ndërkombëtarë për pajiset ushtarake dhe blerjet nga fusha e sigurisë dhe mbrojtjes.

II. OPINIONI PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT BUXHETOR (VNB) TË PROJEKTLIGJIT

Ministria e Mbrojtjes (MM) si organ propozues ka përgatitur vlerësimin e ndikimit buxhetor të këtij projekt ligji për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në formë granti sipas aktit për ndihmë të jashtme të vitit 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armëve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe e ka paraqitur përmes formularit të vlerësimit të ndikimit buxhetor.

Zbatimi në praktik i këtij projekt ligji ka një kosto prej 18,383 € për periudhën 2021-2023, në ketë kosto janë përllogaritur stafi prej 2 zyrtarëve të Ministrisë së Mbrojtjes - Forca e Sigurisë së Kosovës me angazhim të 50% të kohës së tyre të cilët do të bëjnë monitorimin e zbatimit te këtij ligji në praktikë. Kostoja për vitin 2021 është përllogaritur për muajt nëntor dhe dhjetor .

	2021	2022	2023
Pagat dhe Mëditjet	1,083	6,500	6,500
Mallrat dhe Shërbimet	100	1,000	1,000
Shpenzimet Komunale		100	100
Shpenzimet Kapitale			1,000
Totali	**2,183**	**7,600**	**8,600**

Përmes këtij projektligji ratifikohet këmbimi i notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në forma granti sipas aktit për ndihmë të jashtme të vitit 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armeve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara te Amerikës.

III. PËRFUNDIM

Departamenti i Buxhetit në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve shpreh opinionin e vet të pavarur për vlerësimin e ndikimit buxhetor për projektligjin për ratifikimin e këmbimit të notave diplomatike në lidhje me asistencën e ofruar në forme granti sipas aktit për ndihmë të jashtme të viti 1961 dhe aktit për kontroll të shitjeve të armëve mes Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës, sipas të cilës vlerësojmë që zbatimi në praktikë i këtij projektligji nuk paraqet kosto shtesë për Ministrinë e Mbrojtjes – Forca e Sigurisë së Kosovës si zbatuese e këtij projektligji .
Sipas Ligjit Nr. 08/L-016 për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 07/L-041 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021, dhe vlerësimeve për vitet 2022 dhe 2023, kosto e paraparë në shumë prej 18,383 € për zbatimin e këtij projektligji është brenda ndarjeve buxhetore të programit të Forcës së Sigurisë së Kosovë që funksion në kuadër të Ministrisë e Mbrojtjes.

Përgatitur nga:

Bashkim Mehmetaj, Analist i Buxhetit për Ministrinë e Mbrojtjes _____

Milaim Aliu, Udhëheqës i Divizionit të Buxhetit Qendror _____